



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË

AD/GJTHPE/.nr.7/22

GJYKATA THEMELORE NË PEJË, me Kryetarin e Gjykatës Armend Berisha, në procedurën disiplinore ndaj gjyqtarit S.B, duke vepruar sipas ankesës disiplinore të parashtruar nga Kallxo.com përmes monitoruese V.G, pas shikimit të shkresave dhe vlerësimit të ankesës, jashtë seancës, me datë 29.09.2022, mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET ankesa disiplinore e parashtruar nga Kallxo.com përmes monitorueses V.G, ndaj gjyqtarit S.B, **SI E PABAZUAR**.

A r s y e t i m

Me datë 08.09.2022, Kallxo.com përmes monitorueses V.G, ka parashtruar ankesë disiplinore ndaj gjyqtarit S.B me arsyetimin se Prokuroria Themelore në Pejë kishte ndaluar për 48 orë të pandehurin M.M nën dyshimin se ka kryer vepër penale *sulmi ndaj pësonit zyrtar* nga neni 402 par.4 lidhur me par.2 dhe 1 të KPRK – së, si dhe vepër penale *asgjësim apo dëmtim i pasurisë* nga neni 321 par.1 të KPRK- së. Lidhur me këtë rast, gjyqtari i procedurës paraprake S.B ka aprovuar kërkesën e Prokurorisë Themelore në Pejë dhe ndaj të pandehurit ka caktuar masën e arrestit shtëpiak në kohëzgjatje prej një (1) muaji, në të cilin aktvendim shkruan decidivisht se “gjykata ndaj të pandehurit do ta caktoj paraburgimin nëse ai pa lejen e gjykatës e shkelë këtë vendim”. Policia e Kosovës si autoritet kompetent për mbikëqyrjen e zbatimit të masës së arrestit shtëpiak, e kanë hasur të pandehurin jashtë lokacioneve ku ai është dashur të qëndroi sipas vendimit të gjykatës, e përkundër kësaj nuk është ndërmarr ndonjë veprim në kuptim të ndërrimit të masës, për çka gjyqtari fillimisht përmes Zyrës për Informim ka dhënë një përgjigje drejtuar Kallxo.com ku thuhet se: ”Lidhur me pyetjen e parashtruar nga ana juaj, ju njoftojmë se i pandehuri është ende nën masën e arrestit shtëpiak meqë është në diskrecionin e gjyqtarit zëvendësimi i masës së arrestit shtëpiak me masën e paraburgimit” po ashtu, i njejtë në një intervistë të realizuar për Kallxo.com ka deklaruar se i pandehuri çdo herë që ka dalë nga arresti shtëpiak ka dalë me lejen e tij pasi që ka kërkuar leje përmes avokatit të tij A.N por, deklarimin e tillë e ka mohuar avokati N.. Parashtruesja e ankesës ka theksuar se është e paqartë se kur i pandehuri është hasur nga Policia e Kosovës në qytetin e Mitrovicës në një ndeshje basketbolli, si gjyqtari i rastit nuk e ka konsideruar këtë si shkelje të vendimit të masës së arrestit, ani pse i pandehuri është larguar jo vetëm nga shtëpia e tij por, edhe nga qyteti i Pejës andaj, ka kërkuar nga autoritetit kompetent që të vlerësohet fakti se i pandehuri gjatë kohës sa ka qenë nën masën e arrestit shtëpiak është hasur në një ndeshje basketbolli, kundërthëniet mes deklarimit të gjyqtarit B.dhe avokatit N. si dhe të vlerësohen nëse veprimet e gjyqtarit B. mund të jenë në kundërshtim me Ligjin për Procedurën Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve.

Me datë 08.09.2022, Kryetari i Gjykatës duke vepruar në kuptim të nenit 9 par.5 të Ligjit mbi Përgjegjësitë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve e ka njoftuar Këshillin Gjyqësor të Kosovës për ankesën disiplinore të parashtruar nga Kallxo.com përmes monitorueses V.G, ndaj gjyqtarit S.B.

Gjyqtari S.B në deklaratën e tij të dhënë me shkrim lidhur me pretendimet e parashtrueses së ankesës ka deklaruar se të gjitha thëniet e cekura në ankesën disiplinore të parashtruar ndaj tij janë jo vetëm tendencioze, por edhe të pabaza duke shtuar se e vërteta qëndron se ndaj të pandehurit në fjalë e ka aprovuar propozimin e Prokurorisë Themelore në Pejë për caktimin e masës së arrestit shtëpiak, për të cilën masë gjatë seancës dëgjimore janë pajtuar edhe i pandehuri dhe mbrojtësi i tij përveç kësaj, i pandehuri gjatë seancës e ka pranuar edhe fajësinë, ka shprehur keqardhje, ka kërkuar falje disa herë për veprimet e tij dhe ka premtuar asnjëherë nuk do të përsërisë veprime të tilla gjithashtu, thekson se gjatë kësaj seance disa herë të pandehurit ia ka tërheqë vërejtjen për atë se çfarë parashihet me ligj nëse ai pa lejen e gjyqtarit e thyen masën e arrestit shtëpiak. Sa i përket pretendimeve të parashtrueses së ankesës, gjyqtari pohon se i pandehuri ka dal nga arresti shtëpiak, nuk e dinë saktësisht sa herë por çdo herë ka dal me lejen e tij dhe sa herë ka dalë nuk e ka bërë as më të voglën shkelje ndërkohë që prokurori i shtetit me kohë e ka ngritë aktakuzën. Gjyqtari ka theksuar se pohimet e ankesës disiplinore të parashtruar ndaj tij janë shumë afër asaj që është e ndaluar me ligj të bëhet – këto paraqesin asgjë më pak se përzjerje në punën e gjyqtarit përkatësisht, ushtrim ndikimi sepse cilën masë, kur dhe si, pse dhe për çfarë arsye gjithmonë vendos vetëm gjyqtari, të cilin askush nuk ka të drejtë ta urdhërojë se çfarë duhet të bëjë për arsye se gjyqtari bazament e ka ligjin dhe në këtë rast ligji mjaftë qartë me dispozitën e nenit 183 par.1 thekson se “gjyqtari mund të caktoj arrestin shtëpiak për të pandehurin” kurse paragrafi 5 i po këtij neni thekson se “gjyqtari mund të caktoj paraburgim nëse i pandehuri pa leje shkel aktvendimin...”. Nga të lartcekurat, gjyqtari ka theksuar se del qartë se gjyqtari është ai që vendos, heq ose ndërron masën e jo dikush tjetër duke pohuar përfundimisht se këtë çështje penale e ka udhëhequr pa e bërë as më të voglën shkelje andaj, propozon që ankesa disiplinore e parashtruar ndaj tij të hudhet si e pabazuar.

Kryetari i Gjykatës duke vlerësuar ankesën e parashtruar ndaj gjyqtarit S.B, së bashku me deklaratën e tij, ka gjetur se ankesa disiplinore është e pabazuar.

Pretendimet e parashtruara në ankesë se gjyqtari S.B ka kryer shkelje të natyrës disiplinore për shkak se pasi është njoftuar nga Stacioni Policor se i pandehuri të cilit ia ka caktuar masën e arrestit shtëpiak e ka shkelë masën në fjalë meqë është gjendur jashtë lokaleve ku banon dhe përkundër kësaj të pandehurit nuk ia ka caktuar masën e paraburgimit, Kryetari i Gjykatës si autoritet kompetent nuk i vlerëson si shkelje të natyrës disiplinore dhe atë për arsye si më poshtë:

Fillimisht, neni 185 par.5 i Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës ka paraparë se “Gjykata **mund** të caktojë paraburgim nëse i pandehuri pa leje shkel aktvendimin. I pandehuri për këto pasoja gjithmonë duhet njoftuar me kohë”, nga e cila dispozitë rezulton se vendosja lidhur me caktimin apo moscaktimin e masës së paraburgimit ndaj të pandehurit në rast të shkeljes eventuale të masës së arrestit shtëpiak i është lënë në diskrecion gjyqtarit të çështjes ashtu që, në rastin konkret gjyqtari e ka ushtruar funksionin e tij gjyqësor në mënyrë të pavarur në bazë të vlerësimit të tij mbi faktet dhe rrethanat si dhe në pajtim me kuptimin e ligjit. Në rrethana të tilla është irelevante se a ka marrë leje i pandehuri nën masën e arrestit shtëpiak për t’u larguar nga lokalet ku e ka vendbanimin nga gjyqtari personalisht apo përmes mbrojtësit apo se a është njoftuar gjyqtari nga policia se i pandehuri është parë jashtë lokaleve të vendbanimit të tij, për aq kohë sa

ligji ia ka lënë gjyqtarit të çështjes në vendosje ndryshimin eventual të masës për sigurimin e prezencës së të pandehurit në procedurë.

Përfundimisht, Kryetari i Gjykatës si autoritet kompetent, gjeti se mënyra e vendosjes së gjyqtarit nuk hyn në domenin e shkeljeve të natyrës disiplinore të gjyqtarëve dhe se pas analizimit të pretendimeve të parashtrueses së ankesës, deklaratës së gjyqtarit dhe shkresave të nevojshme të lëndës penale, nuk gjeti asnjë bazë për të parashtruar kërkesë për iniciimin e procedurës disiplinore ndaj gjyqtarit S.B.

Nga arsyet e theksuara me lartë, konform dispozitave ligjore të nenit 9 par.6 të Ligjit mbi Përgjegjësitë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve dhe nenin 7 par.3 pika 3.2 të Rregullores të Këshillit Gjyqësor të Kosovës nr.05/2019 për Procedurën Disiplinore të Gjyqtarëve u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË PEJË - AD/GJTHPE/.nr.7/22, me datë 29.09.2022

Kryetari i Gjykatës

Armend Berisha

Vendimi i dorëzohet:

- 1. Këshillit Gjyqësor të Kosovës*
- 2. Gjyqtarit S.B*
- 3. Parashtruesit të ankesës – Kallxo.com – V.G*